



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 11. 02. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu
Ramë Buja, Nexhat Daci, Ardian Gjini dhe Dragisa Miric.

Munguan: Enis Kervan, Lutfi Haziri dhe Ibrahim Gashi

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 26 dhe 28 janar 2009,**
- 2. Miratimi i Planit e Programit të punës të Komisionit për Punë të Jashtme për periudhën janar-korrik 2009,**
- 3. Formimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 26 dhe 28 janar 2009,**

U miratuan procesverbalet nga mbledhjet e dt. 26 dhe 28 janar 2009.

- 2. Miratimi i Planit e Programit të punës të Komisionit për Punë të Jashtme për periudhën janar-korrik 2009**

Sabri Hamiti njoftoi anëtarët e Komisionit se, sipas kërkesës së Kryesisë së Kuvendit për hartimin e planeve dhe programeve të punës së komisioneve për vitin 2009, mbështetur në Strategjinë Legjislative të Qeverisë dhe propozimeve të tjera, është shpërndarë së bashku me ftesën një projekt i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për Punë të Jashtme për periudhën janar-korrik 2009.

Në këtë projekt të Planit e Programit të punës së Komisionit, është paraparë shqyrtimi i P/ligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, shqyrtimi i P/ ligjit për Mërgatën si dhe pika të tjera të bazuara në kompetencat e Komisionit për Punë të Jashtme.

Nexhat Daci tha se në pikën V të Planit dhe Programit të punës ku thuhet “në parim Komisioni formon grup punues për shqyrtimin paraprak të secilit projektligj” Komisioni ngarkohet me më tepër punë se që ka nevojë .

Sabri Hamiti lidhur me diskutimin e z. Daci, sqaroi se është menduar për ligjet në kompetencë të Komisionit për Punë të Jashtme .

Ramë Buja për Programin e punës ku është paraparë shqyrtimi i kandidaturave për përfaqësim diplomatik në muajin prill, mendon se mund të jetë vonë dhe propozon që shqyrtimi i kandidaturave të parashihet edhe në muajin mars.

Sabri Hamiti tha se parashikimi i shqyrtimit të kandidaturave për përfaqësim diplomatik është vështirë të parashihet saktë për shkak të zhvillimit të procedurave të konkursit, megjithatë në muajin prill nuk është vonë të shqyrtohen .

Eqrem Kryeziu kërkoi të informohet më hollësisht lidhur me pikën për vizitë diasporës shqiptare, të paraparë në muajin qershor.

Sabri Hamiti lidhur me pikën për vizitë diasporës tha se kërkesa të tilla kemi pasur edhe më parë dhe ekzistojnë shumë arsye për këtë çështje. Tani me formimin e përfaqësive diplomatike i takon këtij komisioni të merret me problemet e diasporës që lidhen me përfaqësitë e shtetit të Kosovës.

Ramadan Avdiu tha se pika për vizitë diasporës është e domosdoshme në Planin dhe Programin e punës, që ka për qëllim njohjen dhe komunikimin me diasporën.

Xhavit Haliti duke e pasur parasysh se problem kryesor i mërgatës është paisja e tyre me dokumente zyrtare, mendon se duhet marrë nisma për rishqyrtimin e Ligjit për shtetësinë dhe për nxjerrjen e akteve plotësuese nga Ministria e Punëve të Brendshme për shërbimet civile.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P e r f u n d i m

Miratohet Plani dhe Programi i punës së Komisionit për Punë të Jashtme për periudhën janar-korrik 2009.

3. Formimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës

Sabri Hamiti tha se Projektligji për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, është miratuar në parim në seancën plenare të dt. 30.01.2009 dhe jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i tij, ne duhet të procedojmë për miratim të Projektligjit në Kuvend. Për shqyrtimin dhe amendamentimin e P/ligjit, propozoi të formohet një grup punues prej tre anëtarësh.

Anëtarë të grupit punues propozoi: deputetët Ramadan Avdiun, Ardian Gjini dhe Lutfi Hazirin.

Ardian Gjini tha se për këtë P/ligj kam votuar që ti kthehet sponsoruesit në ripunim, sepse nuk mund të amendamentohet, prandaj mendoj se nuk mund të jap kontribut si anëtar i grupit punues për shqyrtimin e tij.

Nexhat Daci anëtarë të tretë të grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, propozoi deputetin Dragisa Miric.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P ë r f u n d i m

Formohet grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, në përbërje:

1. Ramadan Avdiu referues,
2. Lutfi Haziri, anëtar,
3. Dragisha Miriç, anëtar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti